

V E N D I M

Nr.8, datë 25.7.1995

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga :

Rustem Gjata,	Kryetar	i	Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli,	Anëtar	i	“
Manol Konomi,	Anëtar	i	“
Veli Budo,	Anëtar	i	“
Zija Vuci,	Anëtar	i	“
Alfred Karamuço,	Anëtar	i	“
Metush Saraçi,	Anëtar	i	“
Franc Jakova,	Anëtar	i	“

me sekretare Drita Filto, më datat 11.10.1994, 30.6.1995 dhe 25.7.1995, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.12/2 Akti, që i përket :

K Ë R K U E S: 1. FEDERATA E NËPUNËSVE DHE PENSIONISTËVE TË SHQIPËRISË, e përfaqësuar nga Ramazan Mesiti zv/kryetar dhe Sabri Shini e Pasko Vako, pensionistë.

2. 29 PENSIONISTE, nga rrethet Tiranë, Durrës dhe Elbasan.

O B J E K T I

Deklarimi antikushtetues dhe shfuqizimi i:

a) Gërmës “b” të nenit 31 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”;

b) Pikave 2 dhe 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.551, datë 8.11.1993 “Për lejimin e pagesës së pensionit të pleqërisë për pensionistët e punësuar ose të vetëpunësuar në sektorin privat”;

c) Nenit 12 të ligjit nr.7932, datë 17.5.1995 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, në pjesën që bën fjalë për derdhjen e kontributit për sigurimet shoqërore.

GJYKATA KUSHTETUESE, pasi dëgjoi relacionin përkatës,

V Ë R E N:

Sipas nenit 31 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, personat e siguruar kanë të drejtën e një pensioni të plotë bazë në moshën 60 vjeç për burrat dhe 55 vjeç për gratë, pasi ata :

a) të kenë plotësuar 35 vjet sigurim dhe,

b) të jenë tërhequr nga veprimtaria ekonomike.

Federata Sindikale e Pavarur e Nëpunësve dhe Pensionistëve të Shqipërisë dhe kërkuesat e tjerë, të cilët aktualisht janë të vetëpunësuar ose të punësuar në sektorin privat të ekonomisë kushtin e vënë në gërmën “b” të dispozitës së mësipërme dhe që sipas tyre i

ndalon ata të tërheqin pensionin e pleqërisë gjatë kohës që janë të punësuar ose vetëpunësuar, e konsiderojnë se vjen në kundërshtim me paragrafin e parë të nenit 31 të ligjit nr.7692, datë 31.3.1993 “Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”, në të cilin thuhet se “kushdo ka të drejtën e sigurimeve shoqërore në pleqëri ose kur është i paaftë për punë, sipas një sistemi të caktuar me ligj”.

Gjykata konstaton se neni 31 i ligjit për sigurimet shoqërore përcakton kushtet që duhet të plotësohen nga personat në përgjithësi për të përfutur pension pleqërie, ndërsa ndalimi për të tërhequr pensionin e pleqërisë gjatë kohës që pensionisti ndodhet i punësuar ose i vetëpunësuar është i sanksionuar në pikën 2 të nenit 57 të po atij ligji si vijon : “Përfutuesi nuk ka të drejtë për këste përfitimi për çfarëdo periudhe, kur merr pagë ose të ardhura nga veprimtaria ekonomike si i punësuar ose i vetëpunësuar”.

Duke e parë ligjin për sigurimet shoqërore në tërësi, rezulton se sigurimet shoqërore, ndonëse janë të detyrueshme, kanë funksionin e solidaritetit social, mbështetur në parimin që cilido që siguron të ardhura nga puna është i detyruar të derdhë kontribut dhe cilido që ka nevojë për shkak paaftësie (qoftë edhe paaftësi për shkak pleqërie) ka të drejtë të marrë këste përfitimi (përfshi edhe pensionet e pleqërisë), sigurisht në kushtet që përcakton ky ligj.

Sipas nenit 2 të këtij ligji siguri i detyrueshëm është jofitimprurës, ç’ka presupozon se kontributet e mbledhura nga personat që punojnë ndahen për ata që vihen në kushte paaftësie (sëmundje, invaliditeti, pleqërie etj.); ndërsa sipas nenit 65 fondi i sigurimeve shoqërore është i ndarë nga buxheti i shtetit.

Sigurimet shoqërore nuk kanë karakterin e një banke kursimi, prej së cilës secili tërheq atë që ka derdhur, siç pretendojnë kërkuesat me shprehjen “pensionisti merr si pension atë që ka lënë”. Kështu, sipas dispozitave të ligjit, një person që ka derdhur kontribut për vite të tëra mund të mos përfitojë pension pleqërie sepse vdes pa mbushur moshën përkatëse, ndërsa një tjetër e gëzon pensionin e pleqërisë duke u shpërblyer në total me një shumë disa herë më të madhe nga ajo që ka derdhur si kontribut gjatë gjithë kohës që ka qenë në marrëdhënie pune.

Nga sa u tha më sipër, gjykata konkludon se përcaktimi ligjor i pikës 2 të nenit 57 të ligjit për sigurimet shoqërore nuk vjen në kundërshtim me paragrafin e parë të nenit 31 të Ligjit Kushtetues “Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”.

Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.551, datë 8.11.1993 është lejuar pagesa e pensionit mujor të pleqërisë për pensionistët që pas daljes në pension punësohen ose vetëpunësohen në sektorin privat, por gjatë kësaj periudhe ata detyrohen të derdhin kontribut sipas ligjit mbi sigurimet shoqërore.

Ndërsa sipas nenit 12 të ligjit nr.7932, datë 17.5.1995 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, “Këshilli i Ministrave mund të vendosë që pensionistët e punësuar ose të vetëpunësuar në sektorin privat gjatë periudhës së tranzicionit të tërheqin pensionin mujor të pleqërisë dhe të derdhin kontribut për kohën që kryejnë veprimtari ekonomike”.

Nga kjo rezulton se vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 551. datë 8.11.1993 ka fuqi vetëm për periudhën e tranzicionit.

Gjykata i gjen të pabazuara pretendimet e kërkuesave për të mos derdhur kontribut gjatë kohës që ata kryejnë veprimtari ekonomike si të punësuar ose të vetëpunësuar, sepse ato vijnë në kundërshtim me parimin bazë mbi të cilin është ndërtuar

ligji mbi sigurimet shoqërore, sipas të cilit të gjithë personat që sigurojnë të ardhura nga veprimtaria ekonomike janë të detyruar të derdhin kontribut. Falë kontributit të personave që kryejnë veprimtari ekonomike sigurohen të ardhurat për të shpërblyer ata që kanë nevojë, siç u përshkrua më sipër.

Gjithashtu, Gjykata e gjen të pabazuar edhe kërkesën tjetër për shfuqizimin e pikës 3 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.551, datë 8.11.1993, sipas të cilës nuk njihet vjetërsi pune për efekt të ligjit për sigurimet shoqërore koha që pensionistët marrin pension.

Nuk mund të pranohet që të njihet vjetërsi pune periudha gjatë së cilës një person punon si i punësuar ose vetëpunësuar dhe në të njëjtën kohë tërheq pensionin e pleqërisë. Do të njihet vjetërsi pune (ose periudhë siguri, siç shprehet ligji për sigurimet shoqërore) me të gjitha pasojat ligjore koha që personi i punësuar ose vetëpunësuar derdhi kontribut, me kusht që ai mos të ketë filluar përfitimin ose të ketë lënë pensionin e pleqërisë.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë duke u bazuar në nenin 24 pika 2, 3 dhe nenin 26 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe i formës së prerë.

Kundër këtij vendimi votuan Rustem Gjata, Zija Vuci e Veli Budo.

MENDIMI I PAKICËS

Nuk jam i një mendimi me vendimin e dhënë nga shumica e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese përse i përket asaj kategorie të pensionistëve që janë të vetëpunësuar dhe që nuk kanë të punësuar pranë tyre, dmth, që nuk janë njëkohësisht edhe punëdhënës në sektorin privat, vetëm lidhur me detyrimin e tyre për të derdhur kontributin e sigurimeve shoqërore.

Këtë mospajtim me shumicën e arsyetoj si më poshtë:

Me vendim të Këshillit të Ministrave nr.551, datë 8.11.1993, pensionistëve të punësuar ose të vetëpunësuar në sektorin privat ju njoh e drejta për të marrë pension të pleqërisë. Por, njëkohësisht këta janë të detyruar të derdhin kontribut gjatë gjithë kohës që marrin pension dhe kjo kohë nuk u njihet vjetërsi pune për efekt të ligjit “Për Sigurimet Shoqërore...”. Ky vendim i Këshillit të Ministrave është ligjëruar më pas me nenin 12 të ligjit nr.7932, datë 17.5.1995 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin “Për Sigurimet Shoqërore”.

Kjo mënyrë rregullimi me akte normative përse i përket detyrimit të pensionistëve të vetëpunësuar, të cilët nuk janë edhe punëdhënës, mendoj se është në kundërshtim me parimin kushtetues të barazisë para ligjit, parashikuar nga neni 25 të ligjit “Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”.

Për të punësuarit, punëdhënësi është i detyruar të derdhë përqindjen më të lartë të kontributit, vetëm një përqindje shumë më të ulët e paguan i punësuar, kuptohet sipas pagës së realizuar. Këtyre pensionistëve u është njohur mundësia për të zgjedhur edhe mënyrën tjetër, atë të mosmarrjes së pensionit për kohën që kryejnë veprimtari ekonomike, duke fituar të drejtën e vjetërsisë në punë dhe të llogaritjes së pensionit në bazë të kësaj kohe shtesë vjetërsie në punë. Në këtë mënyrë kësaj kategorie personash u krijohet mundësia e përfitimit në të ardhmen e një pensioni më të lartë, pra kundrejt detyrimit të kontributit edhe e drejta e përfitimit.

Vetëm për atë kategori pensionistësh që vetëpunësohen dhe që nuk janë edhe punëdhënës, me aktet e përmendura, nuk krijohet asnjë mundësi përfitimi nga kontributi edhe sikur të mos marrin pensionin. Për ta është caktuar një kontribut i detyrueshëm fiks, pavarësisht nga të ardhurat që marrin. Si rrjedhojë ata vihen në një pozitë jo të barabartë me pensionistët e tjerë, pasi detyrimit të kontributit nuk i përgjigjet asnjë detyrim nga ana e Sigurimeve Shoqërore.

MENDIMI I PAKICËS

Jemi kundër vendimit të shumicës për arsye të mëposhtëme:

1. Legjislacioni i Sigurimeve Shoqërore tek ne, siç duket, ka zgjedhur sistemin që ndalon pensionistin që gjatë kohës që përfiton nga kjo e drejtë nuk duhet të merret me veprimtari ekonomike qoftë duke u vetëpunësuar qoftë duke u punësuar në sektorin privat. Ky parim ka gjetur shprehjen e vet në nenin 57 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

Ato vende që kanë pranuar këtë sistem patjetër janë bazuar në dy faktorë kryesorë. E para në nivelin e lartë të jetesës gjë që u jep mundësi të punësuarve të akumulojnë para për t’i përdorur pastaj pas daljes në pension dhe së dyti, në të ardhurat nga pensioni i plotë i pleqërisë që siguron me to një standard të mirë jetese.

Edhe në legjislacionin tonë kushtetues dhe konkretisht në paragrafin e parë të nenit 31 të ligjit “Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”, thuhet shprehimisht midis të tjerave se kushdo ka të drejtën e sigurimeve shoqërore në pleqëri dhe në zbatim të kësaj, në ligjin “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të përmendur më lart dhe konkretisht në nenin 32 pika 2, thuhet në mënyrë të përcaktuar se shuma bazë e pensionit që u jepet gjithë personave të siguruar, duhet të sigurojë të paktën një standart jetese minimal, i indeksuar çdo vit në lidhje me indeksin e çmimeve të disa mallrave të zgjedhura të përcaktuara në rregulloren e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Është fakt i pakontestueshëm se shuma bazë e personit të plotë të pleqërisë dhe me shtesat e vazhdueshme nuk siguron në asnjë mënyrë një standard jetese minimal për pensionistët. Në këtë mënyrë dispozitat që përcaktojnë masën e pensionit të plotë të pleqërisë qoftë dhe i caktuar në masën maksimale të sasisë vjen në kundërshtim të hapët me dispozitat kushtetuese.

Kjo vërtetohet edhe me faktin tjetër që pikërisht disa muaj pas hyrjes në fuqi të ligjit “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli i Ministrave, në kundërshtim të hapët me ligjin përkatës që ndalon pensionistin të merret me çfarëdo lloj aktiviteti ekonomik, mori vendimin nr.551, datë 8.11.1993 “Për lejimin e pagesës së pensionit të pleqërisë për pensionistët e punësuar ose të vetëpunësuar në sektorin privat”,

sipas të cilit lejohet pagesa e pensionit mujor të pleqërisë për pensionistët që pas daljes në pension vetëpunësohen ose punësohen në sektorin privat.

Ky qëndrim u sanksionua më vonë me nenin 12 të ligjit nr.7932, datë 17.5.1995 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit Këshilli i Ministrave mund të vendosë që pensionistët e punësuar ose të vetëpunësuar në sektorin privat gjatë periudhës së tranzicionit të tërheqin pensionin mujor të pleqërisë.

Mirëpo për zgjidhjen e drejtë të kësaj çështje nuk duhet të lihet mënjane fakti që kur i punësuar ka plotësuar moshën për të dalë në pension, ka arritur një shkallë të caktuar paaftësie, pra është bërë invalid. Dhe në këtë përcaktim shoqëria padyshim është nisur nga kritere shkencore në të cilat janë marrë parasysh një numër faktorësh social-ekonomikë e fizikë, të cilat janë patjetër të lidhura e të justëzuara nga standartet dhe nivelet ekonomike të jetës në vendin tonë, duke u nisur që nga lindja dhe gjatë gjithë jetës së personit, nga natyra e punës deri në arritjen e moshës për të fituar pensionin e plotë të pleqërisë.

Kështu që mundësitë dhe aftësitë për punë të personit, në përgjithësi reduktohen në mënyrë të konsiderueshme prandaj edhe me këto ndryshime të përkohëshme duke i lejuar pensionistët të vetëpunësohen apo të punësohen në sektorin privat zorr se mund të arrijnë ato kushte për të cilat bëhet fjalë në pikën 2 të nenit 32 të ligjit “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

2. Në nenin 12 të ligjit nr.7932, datë 17.5.1995 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, disponohet se pensionistët e punësuar ose të vetëpunësuar në sektorin privat gjatë periudhës së tranzicionit kanë të drejtë të tërheqin pensionin mujor të pleqërisë dhe njëkohësisht duhet të derdhin kontributin për kohën që kryejnë veprimtari ekonomike.

Sipas përmbajtjes së nenit 57 pika 2 të ligjit “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, pensionisti nuk ka të drejtë të tërheqë këste përfitimi për çfarëdo periudhe, kur merr pagë ose të ardhura nga veprimtaria ekonomike si i punësuar ose i vetëpunësuar.

Në vendimin e shumicës është mbajtur qëndrimi se : “nuk mund të pranohet që të njihet vjetërsi pune periudha gjatë së cilës një person punon si i punësuar ose vetëpunësuar dhe në të njëjtën kohë tërheq pensionin e pleqërisë” dhe më poshtë: “Do të njihet vjetërsi pune (ose periudhë sigurimi, siç shprehet ligji “Për sigurimet shoqërore”) me të gjitha pasojat ligjore koha që personi i punësuar ose i vetëpunësuar derdhi kontribut, me kusht që ai mos të ketë filluar përfitimin ose të ketë lënë pensionin e pleqërisë”.

Në këtë rast, me vendimin e saj Gjykata Kushtetuese, i jep fuqi juridike një akti administrativ, i cili kur doli binte në kundërshtim të hapët me Ligjin “Për sigurimet shoqërore” dhe që në kohën e tanishme ky problem gjen zgjidhje në ndryshimet e fundit të ligjit “Për sigurimet shoqërore”.

Një qëndrim i tillë i mbajtur në këtë vendim, mendojmë se është i padrejtë për arsye se e drejta e pensionit është një e drejtë e fituar edhe në kohën që ai është i vetëpunësuar apo punësuar në sektorin privat dhe derdhja e kontributit për sigurimet shoqërore duhet të përbëjë njëkohësisht një detyrim për sigurimet shoqërore për të llogaritur këto vite pune në vjetërsinë në punë të sigurimit për efekt të masës së pensionit pas largimit të pensionistit nga veprimtaria ekonomike. Ndryshe derdhja e kontributit nga

ana e pensionistit mbetet pa kuptim duke përbërë një detyrim të padrejtë në kurriz të pensionistëve.

Tiranë, më 25.7.1995

KRYETARI
Rustem Gjata

A N Ë T A R
Zija Vuci

A N Ë T A R
Veli Budo

Nr. 12/2 i regjistrimit themeltar
Nr. 8 i Vendimit